



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:004442  
Datë: 20.01.2023  
Numri i dokumentit: 03883701

**C.nr.1142/21**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Betim Behluli si dhe më Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësve F. B. dhe R. B. nga fshati Turjakë, Komuna e Malishevës i përfaqësuar nga Av. A. K. nga Malisheva, kundër të paditues Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, sipas bazës juridike kompenzim i dëmit material dhe jomaterial, me datën 19.01.2023 merr këtë:

**A k t v e n d i m**

Konstatohet e **tërhequr** padia e paditësve F. B. dhe R. B. nga fshati Turjakë, Komuna e Malishevës, e parashtruar kundër të paditues Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë me të cilën kanë kërkuar kompenzimin e dëmit material dhe jomaterial.

**A r s y e t i m**

Paditësit F. B. dhe R. B. nga fshati Turjakë, Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit të tij Av. A. K. nga Malisheva kanë parashtruar padi kundër të paditues Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, sipas bazës juridike kompenzim i dëmit material dhe jomaterial.

I autorizuari i paditësve me datë 20.12.2022 me parashtrësë e njofton gjykatën se e tërheqë padinë të parashtruar pranë kësaj gjykate, duke theksuar ndër të tjera se paditësit dhe e paditura kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Meqenëse i autorizuari i paditësve përmes parashtrësës e ka tërhequr padinë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 261, par.1 dhe 3 të LPK-së.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm.  
C.nr.1142/21 me dt. 19.01.2023**

**Gjyqtari  
Betim Behluli**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Aktvendimi në kuptim të nenit 261 par.4 të LPK-së nuk lejohet e drejta në ankesë.